



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 06/5/2018 (dymije e tetembdhjete), une Notere **Perian B. Bodinaku**, Anetare e Dhomes se Notereve Tirane, ne adrese rruga "Çerçiz Topulli" pall.AK,nr 4,Tirane, u paraqiten personalisht palet:

- **Z. Arber Guma** , me atesi Skënder i datëlindjes 20.09.1984 ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes ID Nr. Personal : I40920066W, ne cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te **Shoqërise "CALL CENTER MARKETING SERVICES" sh.p.k**, me numer Nipti : L81804019G, me seli në Tirane , Njesia nr 9, Bulevardi Zogu Pare, Rruga Abdi Kazani, Qendra e Biznesit Tirana, Kati 5.

--**Z. Olsi Poçari** me atesi Maço i datëlindjes 20.03.1984 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes ID Nr. Personal : I40320233R.

I siperpermenduri, bazuar ne nenin 73/1/b te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", nenin 705 dhe vijues te ligjit nr.7850 dt.29.7.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise" kerkuan prej meje noteres perpilimin e kesaj "Kontrate per shitje kuotash" si me poshte vijon:

Neni 1

Palet kontraktuese

Z. Arber Guma , me atesi Skënder i datëlindjes 20.09.1984 ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes ID Nr. Personal : I40920066W, ne cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te **Shoqërise "CALL CENTER MARKETING SERVICES" sh.p.k**, me numer Nipti : L81804019G, me seli në Tirane , Njesia nr 9, Bulevardi Zogu Pare, Rruga Abdi Kazani, Qendra e Biznesit Tirana, Kati 5.

nga ketu e me poshte referuar si Shitesi.

dhe

--**Z. Olsi Poçari** me atesi Maço i datëlindjes 20.03.1984 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes ID Nr. Personal : I40320233R.

nga ketu e me poshte referuar si Bleresi.

Neni 2

Objekti i kontrates

Z. Arber Guma ne cilesine e shitesit zoteron masen 100 % te kuotave te shoqerise: **"CALL CENTER MARKETING SERVICES" sh.p.k** te cilat numri i pjeseve jane 1,00 kuota. Objekti i kesaj kontrate eshte shitja prej Shitesit kundrejt Bleresit te 100 % (njqind) te kuotave, qe Shitesizoteron ne shoqerine **"CALL CENTER MARKETING SERVICES" sh.p.k**

Neni 3

Çmimi i shitjes.

Çmimi total i shitjes se kuotave qe do t'i paguhet Shitesit nga Bleresi eshte 100,00 (njqind) Leke.

Neni 4

Menyra e pageses

Palet deklarojne qe çmimi i shitjes se kuotave i percaktuar ne nenin 3 te kesaj kontrate, eshte likuiduar prej bleresit sipas nje forme te rene dakort ndermjet tyre.

Neni 5

Detyrimet e shitesit

Shitesi do te pranoje çmimin e shitjes, te parashikuar ne Nenin 3, si çmimin e plote dhe perfundimtar te shitjes se 100 % (njeqind) te kuotave te kuotave objekt te kesaj kontrate, qe ai kishte ne shoqerine "CALL CENTER MARKETING SERVICES" sh.p.k -, kuota te cilat tashme i kalojne Bleresit Olsi Poçari

Shitesi garanton se kuotat, te cilat shiten me kete kontrate, nuk jane te lena peng, ne dorezani apo te renduara me ndonje lloj tjeter barre dhe se ai eshte i vetmi pronar i tyre e gezon te drejta te plota mbi to.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Shitesi heq dore nga te drejtat qe ai kishte mbi kuotat objekt i kesaj kontrate dhe Bleresi merr persiper te gjitha detyrimet qe kane lidhje me keto kuota te shoqerise

"CALL CENTER MARKETING SERVICES" sh.p.k

Shitesi do te marre te gjitha masat per te garantuar permbushjen e te gjitha detyrimeve te marra prej tij ne baze dhe per zbatim te kesaj kontrate dhe cdo pergjegjesi dhe detyrim i meparshem i pashlyer para lidhjes se kontrates mbeten ne ngarkim te shitesit.

Neni 6

Detyrimet e Bleresit

Bleresi ka paguar çmimin e blerjes, sipas menyres se parashikuar ne nenin 4 te kesaj kontrate.

Te gjitha asetet, materialet dhe kontratat e bashkepunimit i kalojne bleresit menjeher me blerjen e kuaotave dhe nenshkrimin e kesaj kontrate.

Bleresi do te marre te gjitha masat per te garantuar permbushjen e te gjitha detyrimeve te marra prej tij ne baze dhe per zbatim te kesaj kontrate

Neni 7

Gjuha e Kontrates

Kjo kontrate pergatitet ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, te gjitha te njevlershme dhe origjinale.

Secila prej paleve ne kete kontrate do te marre nje kopje te kontrates.

Neni 8

Konfigurimi i shoqerise

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate konfigurimi i shoqerise do te jete:

Z. Olsi Poçari do te zoteroje 100 % (njeqind) te kuotave te shoqerise, si dhe do te jete administratori dhe ortaku i vetem i shoqerise "Call Center Marketing Services" sh.p.k.

Neni 9

Pas perpilimit te kesaj kontrate, Une noteri e lexova ate me ze te larte ne prani te Shitesit dhe Bleresit, te cilet me deklaruan se e kuptuan permbajtjen e kesaj Kontrate dhe me vullnetin e tyre te lire dhe te plote e pranuan dhe e nenshkruan ate ne pranine time.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate prej paleve, une noteri vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.

SHITESI

Arbet Qazaj

BLERESI

Olsi Poçari



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20180906135953617
Data e Rezultatit të Kërkimit: 06.09.2018
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 1:59:53PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-628-3941
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ARBËR SKENDER GUMA
CALL CENTER MARKETING SERVICES SH.P.K.



Arber Skender Guma